



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**  
**PA1 Nr.08-219**  
**26.08.2024**  
**Shkup**

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 2, neni 82 paragrafi (1) nënparagrafi 5 dhe neni 83 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23 dhe 55/24), dhe në lidhje me nenin 15 paragrafët (1) dhe (6) dhe neni 29 paragrafi (2) të Ligjit për Media („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr.184/13 dhe 13/14 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.63/24 dhe 74/24), neni 51 paragrafi (1) dhe paragrafi (3) dhe neni 52 paragrafi (2) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr.124/15), neni 28 nga Ligji i Kontesteve Administrativ („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr.96/19), duke vepruar sipas Propozimit PA1 nr.08-219 datë 06.08.2024, për iniciimin e procedurës për heqjen dhe Propozimin PA1 nr.08-219 datë 19.08.2024 për miratimin e vendimit për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-3508/2 datë 26.08.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 33-të mbajtur më 20.08.2024 miratoi:

**Vendim**  
**për marrjen e lejes për transmetim në radio të**  
**Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO PRO – FM SHPK Gostivar**

1. I HIQET leja për transmetim në radio, PA1 nr.08-95 datë 07.09.2023, Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO PRO – FM SHPK Gostivar, për shkak se pas dhënies së lejes ndodhën situata që paraqesin pengesa Ligjore për zotëruesin e lejes për kryerjen e veprimtarisë së tij, gjegjësisht për shkak se dhe në afatin plotësues(shtesë) nuk përmbushi detyrimet ligjore dhe Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nuk i dorëzoi të dhënat për strukturën e pronësisë, redaktorin përgjegjës/ redaktorët, burimet e financave në vitin 2023, të ardhurat dhe shpenzimet në total të realizuara nga veprimtaria e kryer në vitin 2023 dhe të dëgjueshmërisë mesatare në vitin 2023.
2. Ky vendim botohet në „Gazetë Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“, në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe në dy gazeta zyrtare, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
3. Ky Vendim është përfundimtar.

**A r s y e t i m**

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, është zotërues i lejes për transmetim në radio, PA1 6p.08-95 datë 07.09.2023, për transmetim nëpërmjet transmetuesit tokësor, në nivel lokal, për zonën e qytetit të Gostivarit, shërbim programor radiomuzikor me format të përgjithshëm, në gjuhën shqipe.

Në pajtim me nenin 15 paragrafi (1) të Ligjit për Media (LM), transmetuesit janë të obliguar deri më 31 mars të vitit vijues në formular të posaçëm të përcaktuar nga organi rregullator kompetent të dorëzojnë të dhëna për: strukturën e pronësisë, gjegjësisht të dhënat për emrin dhe selinë e personave juridik ose emri dhe vendbanimi i personave fizikë që janë pronarë të aksioneve ose pjesë të aksioneve tek botuesi i medias, me të dhëna për përqindjen e aksioneve ose të pjesës së fituar dhe datën kur e kanë fituar, të dhëna për redaktorin përgjegjës/redaktorët, të dhëna për burimet e financimit të transmetuesit në vitin paraprak (reklama, sponsorizimi, shitjet e përmbajtjeve, shërbimet e ofruara palëve të treta dhe të ngjajshme), të dhënat në total të të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara të transmetuesit në vitin paraardhës nga aktivitete e ofruara dhe të dhënat për shikueshmërinë dhe dëgjueshmërinë mesatare të transmetuesit në vitin paraardhës.

Në pajtim me nenin 27 paragrafi (1) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), Agjencia kryen mbikëqyrje administrative, e cila kryhet mbi punën e botuesve të mediave në aspekt të harmonizimit të punës së tyre me kushtet e përcaktuara në Ligjin për Media, Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe rregulloret e miratuara në bazë të tij (neni 29 paragrafi 1 të LSHMAAV).

Agjencia, nëpërmjet Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, ka kryer mbikëqyrje administrative të punës së SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, në aspekt të përmbushjes së detyrimit nga neni 15 paragrafi (1) të LM, nga ku pas kryerjes së mbikëqyrjes së rregullt administrative, në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative (ark.nr.03-2120/1 datë 29.04.2024), është konstatuar se transmetuesi në fjalë nuk e ka përmbushur detyrimin nga neni 15 paragrafi (1) të LM, gjegjësisht Agjencisë nuk i dorëzoi të dhënat për strukturën e pronësisë, redaktorin përgjegjës/redaktorët, burimet e financimit në vitin 2023, totalin e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara nga veprimtaria e kryer në vitin 2023 dhe për dëgjueshmërinë mesatare në vitin 2023.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, Këshilli i Agjencisë në seancën e 25-të, mbajtur më 31.05.2024, miratoi Aktvendim për ndërmarrjen e masës – vërejtje publike PA1 nr.03-167 datë 31.05.2024, ku publikisht paralajmëron SHTR RADIO PRO – FM SHPK Gostivar, për shkëljen e kryer të nenit 15 paragrafi (1) të LM dhe urdhëron që në afat prej 45 (dyzet e pesë) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, të harmonizon veprimtarinë e tij me dispozitat e LM, si dhe pas përfundimit të afatit prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse transmetuesi ka vepruar sipas Aktvendimit.

Agjencia, nëpërmjet Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, ka kryer mbikëqyrje të kontrollit administrativ, sipas të cilit në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer të kontrollit administrativ ark.nr.03-3244/1 datë 24.07.2024, është konstatuar se transmetuesi nuk ka vepruar sipas masës së shqiptuar – vërejtje publike dhe nuk e ka përmbushur detyrimin nga neni 15 paragrafi (1) të LM.

Në nenin 15 paragrafi (6) të LM, parashihet se nëse botuesi i medias dhe në afatin plotësues nuk i përmbush detyrimet e përcaktuara me këtë ligj, atëherë organi rregullator kompetent do t'ia marrë lejen për transmetim në radio në pajtim me LSHMAAV.

Në nenin 29 paragrafi (2) të LM, parashihet se masat që organi rregullator kompetent mund t'i ndërmarrë, dhe që janë të përcaktuara në LSHMAAV, zbatohen përkatësisht dhe në rast të shkëljes së dispozitave të këtij Ligji.

Në nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 3 të LSHMAAV është përcaktuar se nëse konstatohet mos respektim, shkelje ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore, miratuar në bazë të ligjit, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me leje dhe akte të tjera të Agjencisë, ndaj botuesi të medias, Këshilli i Agjencisë mund të ndërmarrë masë – heqjen e lejes.

Në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 5 të LSHMAAV, Agjencia do të heqë lejen për transmetim në radio, para përfundimit të afatit për të cilën është dhënë dhe do të fshijë transmetuesin nga regjistri i radiodifuzerëve, paraprakisht duke i dorëzuar njoftim me shkrim, nëse pas dhënies së lejes ndodhin situata që paraqesin pengesa Ligjore për zotëruesin e lejes për kryerjen e veprimtarisë.

Procedurën për marrjen e lejes për transmetim televiziv ose radio, në pajtim me nenin 83 paragrafi (1) të LSHMAAV, e inicon Këshilli me propozim të drejtorit të Agjencisë.

Për shkak të gjendjes së verifikuar faktike, sipas së cilës zotëruesi i lejes, SHTR RADIO PRO – FM Gostivar, nuk ka vepruar sipas masës së shqiptuar – vërejtje publike dhe në afatin shtesë nuk ka përmbushur detyrimin nga neni 15 paragrafi (1) të LM, personi i autorizuar nga drejtori i Agjencisë, në bazë të nenit 15 paragrafi (6) të LM, neni 82 paragrafi (1) nënparagrafi 5 të LSHMAAV dhe neni 83 paragrafët (1) dhe (2) të LSHMAAV, dorëzoi Propozimin PA1 nr.08-219 datë 06.08.2024, për inicimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO PRO – FM SHPK Gostivar.

Këshilli i Agjencisë në seancën e 32-të mbajtur më 07.08.2024, në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-3384/2 datë 07.08.2024, miratoi Propozimin, PA1 nr.08-219 datë 06.08.2024, për inicimin e procedurës për marrjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO PRO – FM SHPK Gostivar.

Në lidhje me procedurën e inicuar për marrjen e lejes të SHTR RADIO PRO – FM SHPK Gostivar, PA1 nr.08-95 datë 07.09.2023, dhe në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) të LSHMAAV, Agjencia i dërgoi Njoftim transmetuesit në fjalë (PA1 nr.08-219 datë 08.08.2024), në të cilën thuhet se nëse drejtuar Agjencisë nuk paraqet të dhënat për strukturën e pronësisë, redaktorin përgjegjës/redaktorët, burimet e financimit në vitin 2023, totalin e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara nga kryerja e veprimtarisë në vitin 2023 dhe për dëgjueshmërinë mesatare në vitin 2023, në pajtim me nenin 83 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për inicimin e procedurës për marrjen e lejes, PA1 nr.08-219 datë 06.08.2024, të miratojë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio, nga ku në pajtim me nenin 85 paragrafi (2) të LSHMAAV, transmetuesi do të fshihet nga regjistri i radiodifuzerëve.

Njoftimi PA1 nr.08-219 datë 08.08.2024, i është dorëzuar me shkrim me postë rekomanduese SHTR RADIO PRO – FM SHPK Gostivar. Njëkohësisht Agjencia me datë 08.08.2024, ka dërguar shkresë dhe në formë elektronike në adresën zyrtare elektronike të transmetuesit të regjistruar si informacion kontaktues në Regjistrin Qendror të RMV-së dhe në regjistrin e transmetuesve të udhëhequr (mbajtur) nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 83 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli është i detyruar që në afat prej 15 ditësh nga pranimi i propozimit të drejtorit për inicimin e procedurës për marrjen e lejes, të miratojë vendim me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit.

Duke pasur parasysh faktin se zotëruesi i lejes SHTR RADIO PRO – FM SHPK Gostivar, PA1 nr.08-95 datë 07.09.2023, dhe në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga pranimi i Propozimit PA1 nr.08-219 datë 06.08.2024, nga anëtarët e Këshillit të Agjencisë, nuk e përmbushi detyrimin e përcaktuar në nenin 15 paragrafi (1) të LM, drejtori i Agjencisë, paraqiti Propozimin nr.08-219 datë 19.08.2024, me të cilin Këshilli i Agjencisë në bazë të nenit 82 paragrafi (1) nënparagrafi 5 dhe neni 83 paragrafi (3) të LSHMAAV, në pajtim me Konkluzionin e Agjencisë, ark.nr.02-3508/2 datë 26.08.2024, miratoi Vendim me të cilën i mirret leja për transmetim në radio, PA1 nr.08-95 datë 07.09.2023, për transmetim në radio të SHTR RADIO PRO – FM SHPK Gostivar, për shkak se pas dhënies së lejes janë krijuar rrethana që paraqesin pengesa ligjore që zotëruesi i lejes të kryejë veprimtarinë, gjegjësisht për shkak se dhe në afatin shtesë nuk i ka përmbushur detyrimet ligjore dhe Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nuk i dorëzoi të dhënat për strukturën e pronësisë, redaktorin përgjegjës/redaktorët, burimet e financimit në vitin 2023, totali i të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara nga veprimtaria e kryer në vitin 2023 dhe të dëgjueshmërisë mesatare në vitin 2023.

Në pajtim me nenin 84 të LSHMA-së, Vendimi për marrjen e lejes për transmetim në radio është përfundimtar, dhe ndërkaq kundër tij, zotëruesi i lejes ka të drejtë që të parashtrijë padi për ngritjen e kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga pranimi i tij. Procedura para gjykatës kompetente është urgjente.

Në bazë të gjithë kësaj që është theksuar më lartë, u mor vendimi si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuele  
Kryetari i Këshillit,**

---

**Lazo PETRUSHEVSKI**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi për marrjen e lejes Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO PRO – FM SHPK Gostivar, ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të tij.